

## Fletë informacioni për rregullat e izolimit në Saksoni

e vlefshme duke filluar nga data 25 prill 2022

### Çfarë duhet bërë nëse dyshoni se jeni të infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2, nëse rezultati i testit është pozitiv ose në rast kontakti të ngushtë me një të infektuar?

#### 1. NËSE DYSHONI SE JENI TË INFEKTUAR

Testi i shpejtë që keni bërë (pa mbikëqyrje) ka dalë pozitiv ose keni simptoma të COVID-it dhe keni bërë një test PCR?

- Ju duhet të qëndroni në shtëpi (d.m.th. të izoloheni). Ju lejohet të dilni nga shtëpia ose banesa juaj vetëm nëse shkoni te mjeku ose bëni një test PCR.
- Pas një testi të shpejtë pozitiv, duhet të testoheni – nëse keni simptoma, tek një mjek, përndryshe në një qendër testimi.
- Nëse jetoni me njerëz të tjerë, mundohuni t'iu shmangeni atyre sa më shumë të jetë e mundur.
- Ju lutemi informoni punëdhënësin tuaj nëse dyshoni se jeni të infektuar.

Nëse testi PCR është negativ, izolimi mbaron menjëherë. Ruajeni rezultatin negativ të testit. Nëse testi PCR është pozitiv, ju duhet të vazhdoni të qëndroni të izoluar (shih: 2. *Rezultat pozitiv i testit*).

#### 2. NËSE REZULTATI I TESTIT ËSHTË POZITIV

Testi juaj i shpejtë antigen ose PCR-ja juaj ka dalë pozitiv?

- Nëse testi juaj i shpejtë antigen është pozitiv, ju duhet të bëni edhe një test PCR.
- Duhet të rri në shtëpi (dmth. të izoloheni) për të paktën pesë ditë. Me anë të përlogaritësit të karantinës (shih faqen e internetit të rrethit ose qytetit tuaj) mund të llogarisni se kur mbaron izolimi.
- Ju lejohet të dilni, vetëm nëse ju duhet të shkoni te mjeku ose të bëni testin.
- Nëse jetoni me njerëz të tjerë dhe keni pasur kontakte të ngushta me ta në dy ditët e fundit, duhet t'iu thoni menjëherë se jeni pozitiv dhe se këta duhet të bëjnë kujdes (shih: 3. *Personat e kontaktit*).
- Njoftoni edhe të gjithë të tjerët, me të cilët keni pasur kontakt dy ditë para testit ose para shfaqjes së simptomave (shih: 3. *Personat e kontaktit*).
- Rrijuni larg njerëzve të shtëpisë që të mos i infektioni.
- Njoftoni punëdhënësin ose shkollën apo kopshtin tuaj.
- Si dëshmi e infeksionit dhe izolimit tuaj vlen rezultati i testit PCR. Lutemi ta ruani rezultatin e testit. Ky është i domosdoshëm për certifikatën e statusit “i shëruar”.
- Nëse për 48 orë nuk shfaqni simptoma, mund ta mbaroni izolimin tuaj pas ditës së pestë. Në fund të izolimit nuk keni nevojë të bëni test.
- Lutemi tregoni veçanërisht kujdes deri në ditën e 10-të pas fillimit të izolimit: mbani maskë kur t'iu afroheni njerëzve të tjerë, reduktoni kontaktet e juaja dhe mos u takoni me persona të moshuar ose të sëmurë.
- Nëse ndiheni akoma të sëmurë ose keni simptoma, duhet të vazhdoni izolimin (maksimumi deri në ditën e 10-të). Nëse për 48 orë nuk shfaqni simptoma, izolimi juaj mbaron. Humbja e shijes dhe e nuahtjes shpesh zgjat shumë dhe nuk quhet në këtë rast.
- Kush punon në profesione infermierie, në kujdesin mjekësor ose asistencën e integritit, ka nevojë për një test negativ që të mund të kthehet në punë. Kjo nuk vlen kur koha e izolimit ka zgjatur të paktën 10 ditë.

#### 3. NË RAST KONTAKTI TË NGUSHTË ME NJË PERSON TË TESTUAR POZITIV (person kontakti):

Jetoni me dikë që është testuar pozitiv apo keni pasur kontakt të ngushtë të?

- Ju nuk e keni të **detyrueshme** të rri në shtëpi (të izoloheni).
- Të gjithë personat e kontaktit duhet të bëjnë kujdes të veçantë për një periudhë prej 10 ditësh pas testit pozitiv të njerëzve të shtëpisë ose kontaktit të fundit me ta. Duhet të shohin mirë nëse kanë simptoma tipike, të testohen në ditën e 3-të ose 4-të pas kontaktit, si dhe të takojnë sa më pak persona të jetë e mundur dhe të mbajnë maskë. Lutemi mos takoni as persona të moshuar apo të sëmurë.
- Kush ka simptoma, është mirë që të testohet menjëherë dhe më pas konsiderohet si person i dyshuar (shih: 1. *Personat e dyshuar*).

Qendrat e testimi dhe të gjitha informacionet rreth koronës i gjeni këtu:

Faqja e internetit e qarkut të Landit ose e qytetit tuaj, [www.coronavirus.sachsen.de](http://www.coronavirus.sachsen.de)

**Ndihma juaj është tani shumë e rëndësishme, që të mund ta ndalojmë së bashku pandeminë.**